



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:296544
Datë: 19.11.2024
Numri i dokumentit: 06474208

Pml.nr.638/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit V. H., nga M., për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.18/2020 të datës 26.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.693/2023, të datës 06.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 05.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit V. H., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PKR.nr.18/2020 të datës 26.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.693/2023, të datës 06.08.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.18/2020 të datës 26.10.2023, i dënuari V. H., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave

psikotrope dhe analoge” nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj tij është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve dhe dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 24.12.2019 deri më datën 23.01.2020, të dënuarit do t’i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditëve, atëherë dënimi me gjobë në bazë të nenit 43, paragrafi 3 të KPRK-së, do t’i zëvendësohet në dënim me burgim, ku njëzet (20) euro të dënimin me gjobë do të llogariten me një (1) ditë burgim. Duke u bazuar në nenin 267, paragrafi 5 të KPRK-së, është konfiskuar në mënyrë të përhershme sasia e narkotikut e llojit “Marihuanë” në peshë prej 119.82 gram, e cila pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës. Është detyruar i dënuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet (20) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.693/2023, të datës 06.08.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit V. H., dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit V. H., avokati Rifat Bllata, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që i dënuari të shpallet i pafajshëm, apo t’i anulohet aktgjykimet në fjalë dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.366/2024, të datës 22.10.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. të KPP-së, pasi që nuk përmbajnë një arsyetim

të mjaftueshëm, duke i pasur parasysh kërkesat ligjore nga dispozita e nenit 369, paragrafët 6, 7 dhe 8 të KPP-së.

Gjithashtu, sipas mbrojtësit të të dënuarit, me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur edhe ligji penal në dëm të të dënuarit, pasi që i dënuari përveç posedimit dhe përdorimit për vete, nuk ka pasur qëllim të shitjes dhe shpërndarjes së substancës narkotike, si dhe nuk është takuar duke shitur apo shpërndarë substancë narkotike, andaj, edhe mbi bazën e këtyre rrethanave, është dashur që zbatohet edhe parimi “In Dubio Pro Reo”, i parashikuar në nenin 3, paragrafi 2 të KPP-së, në mënyrë që vepra penale të rikualifikohet si “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”, nga neni 269 i KPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë nuk përfshihen me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta për të gjitha çështjet e rëndësishme, ashtu siç parashihet në nenin 369, paragrafët 6, 7 dhe 8 të KPP-së. Në këtë aspekt, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, përveç çështjeve tjera, edhe dashjen dhe qëllimin e të dënuarit, si element të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, si dhe është vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësia e provave kundërtënëse, në veçanti deklaratimet e të dënuarit, në raport me provat tjera që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Duke qenë se ndaj të dënuarit, krahas dënimit me gjobë, është shqiptuar edhe dënim me burgim, arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë përfshin edhe rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rëndësuese të cilat janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit.

Përveç aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, siç është theksuar edhe më parë, me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk është përfshirë as aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ngase në të janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta në lidhje me vlerësimin e pretendimeve thelbësore ankimore të mbrojtësit të të dënuarit.

Gjithashtu, nuk qëndron as pretendimi i mbrojtësit se është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit V. H., pasi që veprimet e të dënuarit, të përshkruara në mënyrë të hollësishme në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i përbëjnë të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së, siç me të drejtë kanë konstatuar dhe arsyetuar edhe gjykatat e instancave më të ulëta, duke i pasur parasysh rrethanat specifike të rastit konkret.

Siç me të drejtë kanë arsyetuar edhe gjykatat e instancave më të ulëta, dashja dhe qëllimi i të dënuarit V. H., si elemente të figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor janë vërtetuar nga rrethanat faktike të këtij rasti, duke u bazuar në nenin 22 të KPRK-së. Kështu, nga shkresat e lëndës, del që Policia e Kosovës tek i dënuari ka gjetur dhe

konfiskuar një qese më substancë narkotike të llojit “Marihuanë”, me peshë rreth 123.7 gram dhe njëmbëdhjetë (11) paketime me substancë narkotike të llojit “Marihuanë” me peshë prej 12.4 gram, të cilën posa ka kuptuar se kanë shkuar zyrtarët policor për kontrollim, ai e ka hedhur jashtë nga dritarja e banjës së shtëpisë. Gjithashtu, nga fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës shihet në mënyrë të qartë se si substanca narkotike është ndarë në paketime të vogla dhe është mbështjellë me letër alumini, kurse nga shkresat tjera të lëndës rezulton që i dënuari V. H., edhe më parë ka qenë i dënuar tre (3) herë me aktgjykime të formës së prerë për vepra penale të natyrës së tillë. Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, në njërën anë, kurse në anën tjetër, duke e pasur në konsideratë edhe sasinë jo të vogël të substancës narkotike, si dhe rrethanat specifike të rastit, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se arsyetimet dhe sqarimet e gjykatave të instancave më të ulëta në lidhje me dashjen dhe qëllimin e të dënuarit, si elemente të figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, janë të drejta dhe gjejnë mbështetje në shkresat e lëndës dhe në rrethanat faktike të këtij rasti. Të gjitha këto që u theksuan më lart, janë rrethana që shpijnë në përfundimin se dashja dhe qëllimi i të dënuarit, kishte qenë shpërndarja ose shitja e substancës narkotike, andaj edhe pretendimit e mbrojtësit të të dënuarit nuk qëndrojnë.

Përndryshe, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se për tu konsideruar se është kryer vepra penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, paragrafi 1 të KPRK-së nuk është e domosdoshme që kryesi të taktohet duke shitur apo shpërndarë substanca narkotike, por që e rëndësishme dhe e mjaftueshme, në kuptim të figurës së kësaj vepre penale është që kryesi “të posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge”.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.638/2024, më datë 05.11.2024

Bashkëpunëtor profesional,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Rasim Rasimi